



Raporti Vjetor
2014



financojme...

Raporti Vjetor

2014



NOA



NOA

financojme...



financojme...

NOA

NOA

we finance



we finance



NOA

financojme...



we finance

financojme...

NOA



we finance

we finance



financojme...



we finance



NOA

financojme...

we finance



NOA

PËRMBAJTJA

- › Profili
- › Misioni/Vizioni
- › Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm
- › Struktura Organizative
- › Momente të Rëndësishme 1998-2014

- › Zhvillimi i Biznesit
- › Rrjeti i Degëve
- › Kredidhënia
- › Produktet dhe Shërbimet tona
- › Marketing, e-Marketing dhe Telemarketing
- › Përgjegjshmëria Sociale
- › Histori Suksesi

- › Menaxhimi i Riskut të Kredive dhe Parandalimit të Mashtrimeve
- › Rikuperimi i Kredive në Vonesë
- › Performanca Financiare e Kompanisë
- › Mbështetja Operacionale dhe e Infrastrukturës
- › Infrastruktura e Rrjetit dhe Siguria
- › Sistemet e Manaxhimit të Informacionit
- › Burimet Njerëzore
- › Rritja e Nivelit të Kualifikimit dhe Trajnimi i Stafit
- › Raporti Auditorëve të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

PROFILI

Që prej momentit të themelimit në vitin 1999, kompania NOA Sh.a, me përkushtim dhe shërbim profesional, ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme nëpërmjet mbështetjes financiare të nevojave dhe planeve të tyre. E njohur në fillimet e saj si PSHM (Partneri Shqiptar në Mikrokredi), dhe më vonë si Oportuniti Albania, qëllimi kryesor i Kompanisë sonë vazhdon të mbetet i njëjtë, në aspektin e nxitjes së ekonomisë në vend si dhe të zhvillimit të biznesit të vogël dhe të mesëm.


Një epokë e re filloi në gusht të vitit 2010, me prezencën e aksionerëve të rinj të NOA Holding, e cila u shoqërua me një transformim të rëndësishëm të kompanisë në aspektin operacional dhe sidomos të imazhit të saj. NOA Sh.a, duke qënë një Institucion Financiar, operon në tregun e mikrofinancës me një infrastrukturë dhe model operacional unik. Ky model nëpërmjet një performace profesionale dhe një stafi të mirë trajnuar, efikasë maksimale në procesim dhe një procedurë të centralizuar aprovimi, ka bërë të mundur krijimin e një portofoli kredie me cilësi të lartë.

Sot NOA Sh.a bën diferencimin dhe krenohet nëpërmjet shërbimit të saj “Shpejtë dhe Lehtë”, për të gjithë klientët si në zonat urbane dhe ato rurale të të gjithë territorit të Shqipërisë.

NOA Sh.a vazhdimisht ka mbështetur dhe mbështet sipërmarrës të të gjithë sektorëve përfshirë prodhimin, bujqësinë dhe blegtorinë, tregtinë dhe shërbimet, duke zhvilluar një portofol të mirë dhe të diversifikuar të kredisë ekskluzivisht në monedhën vëndase, duke menaxhuar vetë riskun e këmbimit.

Rritja e qëndrueshme gjatë këtyre viteve, e kompanisë është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga Partnerë strategjikë me reputacion ndërkombëtar dhe vëndas, të cilët janë faktorë të rëndësishëm në Industrinë e Mikrofinancës në rajon si: BERZH, OMP, BKT, Responsibility Global Microfinance Fund, EFSE, Oiko Credit, Blue Orchard, etj.





NOA
▼
we finance
financoj

NOA



we finance

NOA



financoj

financojme...

we finance



NOA

we finance



NOA


financojme...



NOA

financojme...

NOA



Të ofrojmë
shërbime të
përshtatshme
dhe produkte
financiare
në menyrë
profesionale për
klientë ambiciozë
jashtë fokusit të
Institucioneve të
tjera financiare,
duke ju dhënë
zgjidhje Shpejt dhe
Lehtë nevojave
dhe kërkesave të
tyre.

MISIONI

VIZIONI

Të jemi kompania referencë në industrinë e shërbimeve financiare, duke transformuar kredidhënien komplekse në një proces të thjeshtë financimi nëpërmjet zhvillimeve dhe risive të vazhdueshme; të ofrojmë etikë të lartë në ambjentet tona të punës në mënyre që të jemi zgjedhja e parë si Punëdhënës për talentet e tregut; të gjenerojmë vlera dhe përfitime të qëndrueshme për aksionerët tanë.



NOA

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm





Të nderuar Klientë, Partnerë dhe Aksionerë,

Kam kënaqësinë të ndaj me ju Raportin Vjetor të Vitit 2014, I cili pasqyron një përmbledhje të sfidave, zhvillimeve, rreziqeve dhe arritjeve të kompanisë sonë përgjatë këtij viti. Gjithashtu përfitoj nga rasti të ndaj me ju vizionin dhe strategjinë për vitin 2015, ambiciet dhe pikat e mbështjetjes së kësaj strategjie.

Viti 2014 ishte i pesti vit rradhazi i vështirë si rrjedhojë e një mjedisi jo shumë të favorshëm në Shqipëri, I ndikuar nga kriza ekonomike në mbarë botën, si dhe nga ndryshimet politike në vend. Rritja ekonomike e realizuar ishte vetëm 1.4%, norma e inflacionit me vështirësi arriti në nivelin 1.6%, si dhe shkalla e papunësisë mbeti e njëjtë me atë të një viti më parë 17%. Sektorët kryesorë të ekonomisë që patën rritje ishin sektori i shërbimeve dhe i ai i prodhimeve; ndërkohë ndërtimi vazhdon të jetë në fazë stanjacioni. Kredidhënia për ekonominë gjatë

vitit ka qëndruar në nivel të moderuar me një rritje vetëm 2.2% të portofolit nga viti I mëparshëm, kryesisht e kontribuar nga kredidhënia për biznesin. Raporti I kredive me probleme shënoi 22.8%, pothuajse në të njëjtin nivel të një viti më parë. Pavarësisht nga sa më sipër tregu ka likuiditet dhe depozitat u rritën me të njëjtin trend prej 4.5% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Megjithëse sektori I mikrofinancës u impaktua nga mjedisi jo I favorshëm, mbetet sërisht një sektor dinamik duke shënuar një rritje të portofolit të kredisë me 5.6% gjatë vitit 2014. Niveli I shumës së kredituar nga të gjitha institucionet mikrofinanciare ishte rreth 16 miliard lekë (ekuivalenti i 115 milion euro) përmes 150 degëve në të gjithë vendin. Sot, institucionet mikrofinanciare ofrojnë shërbimet e tyre për më shumë se 65.000 klientë, me një shpërndarje në zona urbane dhe rurale, pa diskriminim gjinor apo burimi të ardhurash.

NOA Sh.a me një eksperiencë prej më shumë se 15 vitesh në tregun shqiptar, vazhdon të mbetet një nga Institucionet financiare më aktive gjatë vitit 2014, duke përforcuar rolin e saj në zhvillimin e bizneseve të vogla & mesme përmes aktivitetit të kredidhënies, në një mënyrë profesionale dhe fitimprurëse. Stafi me profesionalizëm të lartë, i cili është një kombinim i eksperiencave të ndryshme, si dhe mbështetja e vazhdueshme e ekspertëve të Grupit tonë, kanë qenë faktorët kryesorë që e drejtuan kompaninë përgjatë një viti të suksesshëm.

Strategjia e NOA Sh.a për vitin 2014, edhe pse fillimisht shumë ambiciozë, është përshtatur me kujdes gjatë vitit, duke reflektuar sfidat dhe ndryshimet e shpeshta të mjedisit ekonomik shqiptar. Segmentet në fokus kanë qënë bujqësia dhe bizneset e vogla familjare, në zonat urbane dhe rurale, por pa lenë mënjanë segmentin e individëve të cilët për shkak të kushteve të tregut treguan një rritje modeste gjatë vitit të fundit. Portofoli i kredisë u rrit me 8.5%, duke arritur një balancë prej 3.7 miliard lekë (ose 27 milion euro). Gjatë vitit 2014 u është shërbyer rreth 7.500 klientëve të rinj, duke rritur me 8.5% numrin total të klientëve aktive duke e cuar këtë të fundit në 12.000. Si rezultat I një pune intensive në terren nga skuadra jonë e trajtimit të kredive te këqija, në arritëm të mbajmë një cilësi shumë të mirë te portofolit të kredisë, ku indikator i kredive në vonesë më shumë se 30 (PAR 30) ditë ishte vetëm 2.9%. Viti 2014 ishte një vit shumë I rëndësishëm për kompaninë në kuadër të qeverisjes korporative, si dhe rritjen e rolit të kontrollit të brëndshëm me qëllim sigurimin e një mjedisi në përputhje me standartet, për të siguruar një rritje qëndrueshme në të ardhmen.


Viti 2015 pritet të jetë sfidues për tregun e Mikrofinancës, ndaj dhe strategjia jonë do te jetë në linjë me zhvillimet e tregut. Duke ruajtur fokusin në të njëjtët segmente strategjike, si dhe duke rritur më tej depërtimit tonë në treg, ne parashikojmë të kemi të njëjtën rritje të realizuar gjatë 2014, për portofolin tonë të kredise edhe gjatë vitit 2015.

Ne synojmë të jemi të parët në tregun e mikrofinancës, duke u mbështetur në besnikërinë e klientëve tanë si dhe bazuar në investime për zhvillime dhe risi të vazhdueshme. Ne jemi të bindur se do të përmbushim pritshmeritë e të gjitha palevë, sepse kemi të njëjtat pritshmëri për veten, duke konfirmuar angazhimin tonë për të qenë Institucioni Financiar Jo-Bankë kryesor në Shqipëri.


Znj. Herjola Spahiu, EMBA

Drejtor i Përgjithshëm

Stafi menaxhues i NOA sh.a është një skuadër ekspertësh me performancë të provuar në treg, respektivisht në fushat e përgjegjësive që ata mbulojnë. Ky kompozim eksperiencash bankare dhe biznesesh mikrofinanciare përforcon besimin e një kompanie me strategji të qartë dhe solide drejt suksesit në zhvillimin e produkteve dhe segmenteve të reja, shtrirjen dhe përmirësimin e rrjetit të degëve në shërbim të klientëve.



STRUKTURA ORGANIZATIVE



MOMENTE TË RËNDËSISHME 1998-2014



1998

Një bord drejtuesish i përbërë nga specialistë shqiptarë dhe ndërkombëtarë u përzgjedhën për të administruar organizatën Partneri Shqiptar në Mikrokredi, e cila nisi punën e saj në Qershor të vitit 1998 me financimet e USAID-it. Partneri Shqiptar në Mikrokredi u regjistrua ligjërisht si një kompani kursimesh dhe huadhënëse në Dhjetor të vitit 1998 (sh.k.k.).

1999

Partneri Shqiptar në Mikrokredi ndërmori veprime të plota huadhënieje në Tiranë. Gjatë kësaj kohe Partneri Shqiptar në Mikrokredi është zgjeruar në mënyrë të qëndrueshme.

2001

Partneri Shqiptar në Mikrokredi u kthye në një kompani aksionere dhe vazhdoi të zgjerojë aktivitetin e saj në qytete të tjera të Shqipërisë. Në këtë moment numri i klientëve në zonat rurale dhe urbane arriti në 1,000.

2002

Me financim nga USAID dhe në bashkëpunim me Chemonics nëpërmjet një produkti të vecantë për bizneset e vogla (SBE), rriti numrin e klientëve të saj dhe me rreth 1,000 klientë të tjerë.

2007

U licensua nga Banka e Shqipërisë si një Institucion Financiar Jo Bankë.

2010

Një epoke e re filloi me prezencën e aksionerëve të rinj të NOA Holding, e cila u shoqërua me një transformim të rëndësishëm të modelit të biznesit dhe strategjive të tij.

2014

Manaxhimi i portofolit të klientëve në Risk arriti rekordin e tij më të mirë duke shënuar një rënie në nivelin 2.9% të PAR 30.

2014

Institucioni i parë financiar në Shqipëri i cili automatizoi totalisht procesin e kredithënies (që nga aplikim deri në disbursim) nëpërmjet tabletave, duke rritur shpejtesinë dhe cilësinë e shërbimit ndaj klientëve tanë.

ZHVILLIMI I BIZNESIT



Pas sfidave të vitit 2013, kompania jonë synon të vazhdojë dhe të ofrojë më shumë për mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, nëpërmjet mirëmbajtjes së marrëdhënieve të ngushta me klientët dhe investimeve që sigurojnë produkte fleksibël dhe procese inovative, duke dhënë kontributin e saj të vazhdueshëm në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Viti 2014 ka qënë një vit i mbushur me sfida për Departamentin e Biznesit nisur nga ndryshimet. Pasiguria e krijuar në treg ndikoi në punën dhe rezultatet e pothuajse të gjithë institucioneve financiare, qofshin këto Banka dhe jo Banka, si dhe për të gjithë klientët në çdo lloj segmenti.

Pavarësisht dinamikës së ndryshimeve të njëpasnjëshme në situatën politike dhe ekonomike në vend, Departamenti i Biznesit arriti ta kthejë këtë vit, në vit suksesesh duke rritur numrin dhe volumin e kredive të disbursuara krahasimisht me një vit më parë. Rritja e volumit të kredisë ka qënë e konsiderueshme gjatë vitit 2014 por gjithmonë në përputhje me kriteret e riskut, duke siguruar ruajtjen e një norme të ulët të kredive me probleme.


Në fund të vitit 2014, NOA Sh.a zotëron 15% të tregut të Mikrofinances me një numër klientësh aktive rreth 12,000.

RRJETI I DEGËVE

NOA Sh.a operon në treg me 21 degë të shpërndara në të gjithë vendin, duke mbuluar mbi 90% të hapësirës gjeografike të vendit. Prezenca e stafit të dedikuar në degë, ka bërë të mundur ofrimin e një shërbimi profesional dhe të shpejtë. Stafi i shitjeve është i trajnuar, që jo vetëm të arrijë objektivat individualë, por edhe të ofrojnë konsulentë profesionale për klientët e tyre.

Dega Tiranë
Dega Kamëz
Dega Kombinat
Dega Sauk
Agjencia “Rruga Durrësit”
Agjencia “Unaza e Re”
Agjencia “Komuna e Parisit”

Dega Shkodër
Dega Lezhë
Dega Fushë Krujë
Dega Durrës
Dega Elbasan
Dega Pogradec
Dega Korçë
Agjencia Bilisht
Dega Berat
Dega Lushnje
Dega Fier
Dega Vlorë
Dega Sarandë
Dega Gjirokastër



Degët e NOA



Zonat e mbuluara

Përmirësimi i imazhit të kompanisë dhe degëve tona nga ana infrastrukturore ka qënë në fokus gjatë gjithë vitit 2014, e përforcuar kjo edhe me zgjerimin e rrjetit duke hapur degë të reja në zona potenciale për kompaninë.

➤ Zhvendosja e degës në Vlorë;

➤ Hapja e tre agjensive të reja në Tiranë;

Dega Vlore



Agjencia Komuna e Parisit



Agjencia Rruga e Durresit



Agjencia Unaza e Re


KREDIDHËNIA

Me rreth 100 këshilltarë financiarë në terren duke shkuar ne tek klienti në zona rurale dhe urbane, portofoli i kredisë u rrit me 7.9 % gjatë vitit 2014, duke konsistuar në 7,425 numër kredish të reja. Pjesën më të madhe të portofolit e përbën kredia për biznesin 68.3% dhe kredia për bujqësinë 24.4%. Kredia për bizneset gjatë vitit 2014 pati një rritje prej 16.4%. Rritje shënoi gjithashtu dhe kredia për individët në nivele më të moderuara 1.3%. Produkti më i shitur është kredia me shumë qellime e cila përbën 46.8% të portofolit të kredisë. NOA i jep një rëndësi të vecantë zhvillimit të grave në biznes, nëpërmjet financimit të grave duke u paraqitur në fund të vitit 2014 në masën 20.4% e portofolit të kredisë.

Shpërndarja e klienteve sipas zonave 2014

Numri i klientëve

52.3 % Urban



Portofoli në volum


47.7% Rural



Shpërndarja e klienteve sipas segmenteve 2014

Numri i klientëve

61.9% Business




Agriculture 27.5%

Individuals 10.6%

Portofoli në volum

68.3% Business



Agriculture 24.4%

Individuals 7.3%

PRODUKTET DHE SHËRBIMET TONA

Gjatë vitit 2014 NOA i shtoi gamës së produkteve produkte të reja të dedikuara për segmente të ndryshme klientele:

Kredi për Makina të përdorura – Produkt për çdo kategori klientele, me procedurë të përsheptuar. Ky produkt i vjen në ndihmë çdo individ apo biznesi që nuk ka kushtet dhe kapacitetet të blejë një makinë të re, të blejë një automjet të përdorur për të plotësuar nevoja personale apo punë. Për t'i ardhur në ndihmë klientëve në përzgjedhjen e automjetit, NOA krijoi faqen e web-it www.autokredi.al, në të cilën mund të postojnë falas informacion për makina në shitje çdo tregtar automjetesh, individë etj. Ndërkohë çdo klient i interesuar mund të zgjedhë një makinë, të llogarisë këstin dhe të aplikojë online për të përfituar një kredi.

Kredi e shpejtë për Bizneset deri në 1,000,000 lekë – Është një kredi që i vjen në ndihmë bizneseve të licensuara. Duke mos patur kriter destinacionin e kredisë, si dhe e ofruar pa kolateral, çdo biznes mund të plotësojë kërkesat e biznesit të tij në kohë rekord.



• Agrobiznese



• Biznese

• Aprovim Brenda Ditës

• Dokumentacion

• Sh

Call Center:

068 400 14 03
www.noa.com.al

Kredi e paraaprovuar për studentë – Produkt i ofruar për të gjithë studentët për mbulimin e shpenzimeve universitare, master ose doktoraturë. Duke e konsideruar arsimin një investim për të ardhmen e individit dhe të të gjithë vendit, me produktin e paraaprovuar për studentë, NOA bën të mundur realizimin e ambicjeve arsimore.

Kredi agro – Bazuar në eksperiencën e gjatë që kompania NOA ka në financimin dhe mbështetjen e Agrobiznesit, u hodhën në treg dy produkte të reja të dedikuara për këtë sektor me fokusin kryesor plotësimin e nevojave që ka ky segment. E veçanta e këtyre produkteve ishte mënyra automatike e analizës financiare, nëpërmjet një matrice të ndërtuar nga stafi profesional dhe ekspert i NOA, si dhe mënyra e pagesës së kësteve mujore të kredisë në përputhje me ciklin e të ardhurave që realizohen.



Autokredi

Kredi për Studime



minimal

ërbim në vendin tuaj të punës

- Shpejt dhe me procedurë të thjeshtuar



MARKETING, E-MARKETING DHE TELEMARKETING

Në aspektin e marketing-ut gjatë vitit 2014 është punuar me profesionalizëm dhe dedikim për të ndërtuar një imazh të kompanisë sipas standarteve më të mira, duke ofruar fushata marketing-u koherente dhe lehtësisht të kuptueshme për klientët tanë.

Gjatë vitit 2014 janë zhvilluar 2 fushata të integruara marketingu në pranverë dhe në vjeshtë të cilat kanë patur si qëllim jo vetëm promovimin e produkteve tona në mënyrë profesionale, por edhe rritjen e imazhit të kompanisë dhe të vlerave që NOA Sh.a përcjell. Të dyja këto fushata kanë pasur shtrirje të gjerë në mbarë vendin nëpërmjet transmetimeve në televizionet kombëtare por edhe promocion të dedikuar në zonat urbane dhe rurale të qyteteve më të mëdha të Shqipërisë si Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Korçë, Pogradec, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë gjithashtu në Tiranë dhe gjithë zonat e saj.





Një nga aktivitetet e rëndësishme të organizuara nga departamenti i marketingut ishte edhe ai me rastin e përvjetorit të 15-të të kompanisë NOA Sh.a në Shqipëri. Ky aktivitet ofroi mundësinë që klientet tanë më të rëndësishëm, partnerë të biznesit, mbështetës nga qeverisja qendrore dhe vendore të mblidhen në një mbrëmje falenderimi për mbështetjen dhe bashkëpunimin me NOA Sh.a ndër vite.

Një shërbim i sukseshëm ka qenë promovimi i kanaleve alternative të shitjes për të arritur klientin sa më lehtë dhe më shpejt, nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët tanë në të gjithë vendin dhe referimeve të klientëve tanë më të mirë. Shërbimi i telemarketing-ut ka funksionuar në mënyrë proaktive gjatë proceseve të shitjes, duke bërë të mundur informacion të menjëhershëm në distancë për shërbimet dhe produktet tona, si dhe për ofertat promovionale të aplikueshme për klientelen tonë.



PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

Kompania jonë, përveç se një bashkëpunëtor i rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e agrokulturës, biznesit të vogël dhe të mesëm, synon të kontribuojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, zhvillimin dhe mbrojtjen e vlerave kulturore, sportive dhe sociale. Synimi kryesor i NOA Sh.a është që të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë me hapa të qëndrueshëm dhe duke u bazuar në parimet e mirëqenies sociale për të gjithë klientët dhe popullsinë.

NOA Sh.a e mbështet financimin e klientëve në aftësinë paguese që ata kanë duke u kujdesur të mos mbingarkojë klientët me kredi të cilat nuk i shlyejnë dot.

Gjthashtu, në vijim të përgjegjshmërisë sociale kompania ka përjashtuar nga financimi të gjitha subjektet që ndotin mjedisin, që promovojnë vese në shoqëri si lojrat e fatit etj.

Duke marrë në konsideratë se donacionet dhe sponsorimet përbëjnë një burim të rëndësishëm të mbështetjes së iniciativave në shumë fusha me interes publik, të cilat prekin jetën e një pjese të konsiderueshme të popullsisë, NOA Sh.a është angazhuar në aktivitete të rëndësishme për mbështetjen e njerëzve me aftësi të kufizuara si dhe të invalidëve.



- NOA SH.a, Sponsor gjeneral i Kampionatit Ndërkombëtar të Ping Pong BITT2014, Maj 2014.



- Donacion Shoqatës së Invalidëve të Punës Shqipërisë në Lushnjë, Qershor 2014.





ALI DEDJA

Fermer me sera,

“Bizelja, ky është produkti. Është e çuditshme se si një vendim mund të bëjë dallimin mes një viti të mirë e një viti më pak të mirë”, thotë Ali Dedja

“Ne kemi marrë një fitim shumë më të mirë nga bizelja se sa nga domatja, të cilën kultivua vitin e fundit, ndaj ky ndryshim ishte një vendim i lehtë”, shton Aliu.

Me kredinë e parë në NOA në vitin 2009, pak më shumë se 8,500 euro, ai kishte ngritur serën e tij të parë në tokën prapa shtëpisë, për të rritur më shumë perime, si në aspektin e sasisë dhe të diversitetit.

“Përveç ekspozimit të mirë në diell, erës dhe tokës shumë pjellore, më e rëndësishme është se gruaja ime dhe unë formojmë një ekip shumë të mirë” thotë ai.

Rritja e prodhimeve në serën e tij, i mundësoi Aliut të rrisë ndjeshëm produktivitetin dhe për më tepër të ketë prodhime më të qëndrueshme.

“Një produkt me cilësi të qëndrueshme, është çfarë kërkojnë klientët e mi”, thotë Aliu.

“Kur është fjala për qëndrueshmëri dhe rritje prodhimi, ngritja e një sere është mënyra më e mirë”

Me kredinë e fundit nga NOA, në Korrik të vitit 2013, rreth 2,000 euro ai bleu fara të reja. Ky investim i mundësoi Aliut prodhime sipas kërkesave të tregut, si dhe rritje të prodhimit të kulturave të cilat ishin më të përshtatshme me kushtet e klimës dhe tokës. “Ne u menduam gjatë për këtë, por kalimi nga domatja tek bishtaja ka qenë deri më tani një nga vendimet më të mira që kemi marrë”.

“Si një rritës, kupton që disa gjëra duan kohë dhe ajo çfarë merrni në këmbe varet nga ajo që investoni në të. E njëjta gjë është dhe me biznesin. NOA ndan me ne këtë filozofi duke na bërë krenarë të shohim me kënaqësi fermën tone të vogël të rritet në një ndërmarrje të fuqishme

HISTORI





SHKËLZEN XHETANI,

Bukë pjekës

Të besosh tek vetja dhe në cilësitë e tua është një gjë e mirë. Kjo mund të mjaftojë për të filluar një biznes, por ajo që të bën të vazhdash përpara është kur të tjerët fillojnë të ndajne vizionin tënd dhe të bashkohen për të të ndihmuar ta bësh atë realitet. E dija që mund të kisha besim tek familja ime, por tani e di që mund të kem besim edhe tek NOA!

Ky djalë i ri, furrën e bukës fillimisht e hapi në një ambient të shtëpisë së tij me kredinë e parë tek NOA. Çdo mëngjes ai ngrihet herët dhe pjek bukë të freskët për klientët. Ai thotë se buka e tij është shumë e kërkuar dhe se e shet të gjithë prodhimin çdo ditë. Shkëlzeni fillimisht mori një kredi të vogël tek NOA, dhe më pas gradualisht shuma më të mëdha për të rritur dhe zhvilluar biznesin e tij. Ai është në gjendje të paguajë pa problem kredinë, të blejë furnizimet për biznesin si dhe të kursejë para për familjen e tij.

Ai thotë,

“Ne i jemi mirënjohës NOA-s sepse na ndihmon në rritjen e mëtejshme të biznesit tonë.”

Sfida më e madhe është jo vetëm të sigurosh vazhdueshmërinë e biznesit, por dhe ta rrisësh atë. Duke i ndenjtur besnik njohurive të marra, duke ecur hap pas hapi drejt mundësive të reja duke qenë i gatshëm për ti rezistuar dhe kohëve të vështira. Pikërisht në këto raste ndihem mirënjohës që kam një partner të besueshëm financiar!

SUKSESI





**PAVARËSISHT VESHTIRËSIVE
DHE PENGESAVE TË HASURA
NË TREG, NOA KA MBETUR
UNIKE DUKE SJELLË NOVACION
NË PRODUKTE, SHËRBIME
DHE TEKNOLOGJI**


MENAXHIMI I RISKUT TË KREDIVE DHE PARANDALIMIT TË MASHTRIMEVE

Dinamika e aktivitetit të kredisë gjatë vitit 2014, u shoqërua me një fokus të madh në ruajtjen e cilësisë së portofolit dhe rikuperimin e kredisë në vonesë. Modeli aktual i Biznesit, ku vlerësimi i riskut bëhet nëpërmjet një strukture të pavarur nga forca shitëse, prezente në cdo degë, ka provuar të jetë i sukseshëm dhe njëkohësisht parandalues për kredihënje jo të shëndetëshme. Vendimarrja e decentralizuar nëpërmjet Komiteteve Lokale të Kredisë siguron për një efikasitet maksimale dhe cilësi të mirë portofoli. Kjo reflektohet edhe në treguesit kryesorë të cilësisë së portofolit, të cilët gjatë vitit 2014 treguan përmirësim të ndjeshëm krahasimisht me vitin e mëparshëm:

- PAR 1 u zvogëluar nga 4.9% në 4.7% (niveli historik më i ulët)
- PAR 30 u mirëmbajt në të njëjtin nivel 2.9%, si një vit më parë
- PAR 90 vazhdoi të zvogëlohej nga 2.3% në 1.5%

Faktorët kryesor që kanë ndikuar në mbajtjen e treguesve të tillë pozitivë:

- Selektim i kujdesshëm i klientëve nëpërmjet standardeve të mirëpërcaktuara nëpërmjet politikave të produkteve;
- Komiteti i kredisë i formalizuar në nivel dege me pjesëmarrjen direkte të aprovuesve të kredisë që raportojnë në Departamentin e Riskut në Zyrën Qëndrore;
- Monitorim i ngushtë i klientëve nëpërmjet sistemeve automatike (sms) dhe menaxherëve të portofolit në terren (staf i dedikuar për mbledhjen e kredisë në vonesë);
- Pro-aktiviteti i njësisë për parandalimin e mashtrimit, ndërtuar mbi një sistem sinjalesh dhe raportesh të automatizuara;
- Aktiviteti me frekuencë mujore i Komitetit të Riskut dhe Parandalimit të Mashtrimit me Kreditë, të cilët bazuar në analiza të riskut sipas degëve, segmenteve, produkteve, këshilltarëve financiarë dhe aprovuesve të kredisë, proceseve operacionale marrin vendime të menjëhershme për situata të caktuara.




RIKUPERIMI I KREDIVE NË VONESË


Rikuperimi i kredive në vonesë kryhet nga një strukturë e dedikuar për mbledhjen e kredive, e përberë nga 42 menaxherë portofoli në terren, të cilët janë pjesë strukturës së Degës, por në varësi funksionale nga Drejtori i Departamentit të PAR (Portfolio at Risk) në zyrat qendrore. Aktiviteti i monitorimit të portofolit dhe mbledhjes së kredive në vonesë kryhet nëpërmjet një sistemi totalisht të automatizuar, i zhvilluar enkas për NOA Sh.a, i cili siguron mbajtjen e një ritmi operacional dinamik dhe të mirëstrukturuar. E njëjta efikasitet dhe procesi të kredidhënies egziston edhe në procesin e monitorimit dhe mbledhjes së kredive, duke siguruar një identifikim shumë të shpejtë të problemeve në ripagimin e kredive dhe ndërtimin e planit përkatës për të siguruar mbledhjen e saj.

Ristrukturimet e kredive me probleme shikohen me një prioritet të vecantë, në mënyrë që të ofrojnë lehtësira pagese për klientin dhe për të mundësuar rikuperimin e kredisë. Në rast të mospageses totale prej klientëve, edhe pas hapave lehtësues të ndërmarra, proceset ligjore për mbledhjen

e kredive, janë rregulluar në mënyrë të shpejtë dhe korrekte, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të klientëve për detyrimet dhe shlyerjen e tij. Kjo ka sjelle rezultate të cilat janë inkurajuese për vijimësinë e suksesit tonë në këtë fushë, duke e kthyer këtë strukturë në një burim të rëndësishëm të ardhurash për kompaninë. Përveç monitorimit dhe mbledhjes së kredive aktive në vonesë, objektivi rëndësishëm i kësaj strukture është arkëtimi i kredive të humbura në periudha të mëparshme, aktiviteti i cili ka ardhur në rritje nga viti në vit. Gjatë vitit 2014 u mbledhën afërsisht 173 milion Lekë kundrejt 171 milion Lekë të mbledhura gjatë 2013. Ndërsa mbledhja e kredive jashtë bilancit ka ardhur në rritje ndër vite, kreditë e nxjerra jashtë bilancit këto 2 vitet e fundit janë zvogëluar ndjeshëm, duke treguar për një përmirësim të administrimit të portofolit të kredive në vonesë. Gjatë vitit 2014 u nxorrën jashtë bilancit 170 milion lekë kredi të humbura kundrejt 225 milion Lekë të nxjerra gjatë vitit 2013, ose e thënë ndryshe kjo 25% më pak.




Totali i Portofolit në Risk



Duke pasur eksperiencë të gjatë në këtë fushë, një sistem efikas dhe një strukturë njerëzish të trajnuar dhe dedikuar për monitorim portofoli dhe rikuperim të kredive në vonesë, NOA Sh.a gjatë vitit 2014 ka ofruar me sukses shërbimin e mbledhjes së kredive në vonesë edhe për Institucione të tjera financiare në treg.

Portofoli në risk 1+



PERFORMANCA FINANCIARE E KOMPANISË


Gjatë vitit 2014 objektivi i kompanisë për të patur një rritje të kontrolluar fitimprurëse nëpërmjet një administrimi të përmirësuar të rrezikut dhe cilësisë së portfolit u arrit pothuajse në të gjithë treguesit kryesorë të performancës.

Totali i aktiveve u rrit me 5.2% gjatë vitit 2014, kjo si rezultat i rritjes me 7.9% të tepricës së kredive, e kontribuar kryesisht nga portofoli i kredive në segmentin e bizneseve me një rritje prej më shumë se 15.6% dhe në segmentin e bujqësisë dhe blegtorisë me një rritje 26.2%.


➤ Rritja e portfolit të kredisë u mbështet nga rritja prej më shumë se 7.5% e linjave të kredive të marra nga kompania në tregun lokal dhe ndërkombëtar si dhe nga rritja e kapitalit me 16% si rezultat i fitimit neto të vitit.



Totali i Aktiveve 2011-2014(in mln)



Totali i Detyrimeve 2011-2014(in mln)



Balanca e parasë dhe pozicioni i likuiditetit në fund të vitit 2013 ishin të shëndetshme duke pasur parasysh gjithashtu që ishte kontraktuar një shumë prej 11 milion Euro (ose ekuivalenti i tyre në Lekë) për kreditë e reja gjatë 2014-n. Vendosija e interesave për produktet e kredive që targetojnë segmente të caktuara bëhet duke konsideruar riskun dhe evidencën e humbjeve potenciale respektive për segmentet me të cilat NOA Sh.a punon dhe targeton, ndërkohë që mirëmbahet dhe tregohet përkushtim për një shërbim të shpejtë dhe të lehtë në të gjithë kompaninë. Bazuar në modelin e përfitueshmerisë së produktetve janë ndërmarrë në disa raste fushata marketingu dhe promovionale.


Të ardhurat operacionale u rritën me 16% gjatë vitin 2014 krahasimisht me vitin 2013 ndërsa shpenzimet operacionale

u rritën vetëm me 8%, duke optimizuar raportin e shpenzimeve operacionale me të ardhurat operacionale në nivelin 71% kundrejt 76% që ishte në vitin 2013.


Politika e kompanisë për të pasur një rritje të qëndrueshme në treg dhe për të ofruar norma interesi më të mira për klientët tanë, ka bërë që normat e interesit të produkteve të rishikohen disa herë brenda vitit, duke u ulur rreth 5%, kjo e ndihmuar edhe nga ulja e kostos së fondeve në të njëjtin nivel. Ndërkohë që rritja në tërësi e portofolit rezultoi me një rritje të të ardhurave operacionale.

Të ardhurat neto nga kreditë e fshira u zvogëluan me 6% në vitin 2014 kundrejt 2013, megjithatë kjo ishte e shoqëruar në një ulje të konsiderueshme të shpenzimeve për provigjonet e kredive të këqija me 12%. Të ardhurat nga kreditë e fshira mbetet një nga faktorët e rëndësishëm të performancës së arritur financiare.

Kthimi mbi Kapitalin 2011-2014(in mln)



Fitimi Neto 2011-2014(in tsd)



Shënim: Shifrat në grafikët më sipër i referohen aktivitetit të NOA brenda territorit të Shqipërisë

MBËSHTETJA OPERACIONALE DHE E INFRASTRUKTURËS

Gjatë tre viteve të fundit NOA ka arritur të menaxhojë me sukses implementimin dhe përmirësimin e standarteve të proceseve operacionale në degë, duke siguruar kontrollet e nevojshme të bazuara në parimin e “katër syve”, si dhe ndërtimin e infrastrukturës dhe sistemeve informatike që mbështesin plotësisht rritjen dhe zgjerimin e biznesit në vitet pasardhëse. Bashkëpunimi dhe koordinimi me të gjithë departamentet në kompani është çelësi i suksesit në dhënien e zgjidhjeve teknike e operacionale dhe shfrytëzimin e burimeve të nevojshme. Pika jonë e fortë qëndron tek stafi i mirëpajisur me dije dhe aftësi profesionale për të kuptuar dhe përshtatur mjetet krijuese sipas nevojave dhe kërkesave të klientit në mënyrë të përgjegjshme dhe me kosto efektive.



INFRASTRUKTURA E RRJETIT DHE SIGURIA

Ekspertiza teknike e stafit ka siguruar ndërtimin e një rrjeti informatik të qëndrueshëm dhe të sigurtë, të fuqizuar me teknologji të avancuara, duke lehtësuar zhvillimin dhe përdorimin e aplikacioneve nga përdoruesit në rrjetin e brendshëm të kompanisë. Rrjeti i brendshëm përbëhet nga 21 degë, që menaxhohen në mënyrë të centralizuar. Rrjeti i NOA Sh.a ofron standartet më të larta të sigurisë dhe profileve të përdoruesve nëpërmjet pajisjeve hardware e software, që përmbushin të

gjitha parametrat teknike të sigurisë sipas rregulloreve dhe standarteve në fuqi. Një qendër e rikuperimit teknik është ndërtuar sipas planit të vazhdimësisë së biznesit, e cila siguron aksesin në informacionin kritik dhe rikuperimin e të gjithë proceseve të NOA-s me një shkëputje minimale në raste katastrofash. Testi operacional i kryer me sukses nga të gjithë funksionet përgjegjëse në kompani, konfirmoi funksionalitetin e kësaj qendre.



SISTEMET E MANAXHIMIT TË INFORMACIONIT

Sistemi bazë në NOA Sh.a është ofruar nga Temenos, modeli T24, i cili gjatë 14 viteve të fundit renditet vazhdimisht në vendin e parë ose të dytë nga institucionet që kryejnë çdo vit vlerësimin botëror të platformave bankare. Temenos T24 bazohet në standarte teknologjike që mundësojnë pavarësinë e platformave të përdorura, komunikimin në kohë me sisteme të tjera, performancë të lartë gjatë përdorimit, mundësinë për të përshtatur dhe konfiguruar modulet e tij sipas proceseve të institucionit. Temenos T24 lehtëson vendimarrjen gjatë procesit të kredive duke ofruar një bazë raportimi të gjerë e konceptuar për të gjeneruar raportet më të rëndësishme në institucion si Pasqyrat Financiare, rivlerësimet dhe fluksin e parasë, si dhe raporte të tjera të nevojshme për Manaxhimin.

Që prej vitit 2012, NOA ka aplikuar sistemin SASPO, aplikacion për menaxhimin e proceseve për mbledhjen e kredive të këqija. Me anë të këtij sistemi është arritur përpunimi dinamik i të dhënave dhe organizimi i detyrave ditore për grupe specifik përdoruesish sipas përgjegjësiive respektive të mirëpërcaktuara. Fleksibiliteti që ofron SASPO, siguron jo vetëm përputhshmëri me standartet dhe rregullatorët e përcaktuar, por ka përmirësuar ndjeshëm eficienten e proceseve në kompani duke e renditur në këtë mënyrë si një nga sistemet më të rëndësishme të saj.

Përveç dy sistemeve të lartpërmendura, NOA ka në përdorim edhe sisteme të tjera satelite, të cilat lehtësojnë procese të ndryshme operacionale në kompani si: veprimet kontabël, administrimin e aseteve, analizat financiare të kredive, dërgimin automatik të mesazheve tek klientët dhe funksionimin e qendrës operatore.


Sfida më e madhe gjatë vitit 2014 për NOA ishte ristrukturimi i të gjithë procesit të kredidhënies nga momenti i identifikimit të një potenciali përgjatë cikleve të kredisë, duke krijuar një sistem “NOA Field Technology” (NFT), i cili mban të dhëna, vlerëson dhe rregullon autoritetin përkatës gjatë gjithë procesit të kredisë që nis me krijimin e një potenciali deri në disbursimin e kredisë e ndjekur, nga procese monitorimi deri në likuidim.

Qëllimi i projektit ishte përmirësimi i shërbimit dhe transformimi i operimit të kredive në një proces eficient, të përshtatshëm me fokus Klientin. Me realizimin e NFT, NOA Sh.a konfirmon dhe forcon markën e saj në treg me një vizion unik për të shërbyer Shpejt dhe Lehtë, duke udhëhequr gjithashtu edhe risitë e reja teknologjike të cilat sillen në treg për të përmirësuar shërbimin ndaj klientëve.

Shërbimet tona financiare vijnë tek klienti natyrshëm, në vendin e tyre nëpërmjet teknologjise që mund të përshkruhet si një “bankë e levizshme”, duke ulur kohën e përgjigjes së çdo kërkesë klienti brenda 5 minutave dhe kohës së lëvritit të një kredie deri në maksimumi 1 orë.

BURIMET NJERËZORE

 PUNONJËS 304



PUNONJËS NË ZYRAT QËNDRORE 61



243 PUNONJËS NË DEGË



MANAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Kompania NOA Sh.a, e njohur si një punëdhës i shanseve të barabarta, mjaft aktiv dhe dinamike në tregun e punës numëroi në fund të vitit 2014, rreth 304 punonjës, në raportin 1/1, meshkuj dhe femra, me një shpërndarje të stafit, prej rreth 80 % në degë dhe 20 % në zyrat qendrore.

Ne vazhdimisht synojmë reformimin e politikave të burimeve njerëzore, ku rritja e nivelit të kualifikimit dhe trajnimit të punonjësve, motivimi dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor përbën fokusin kryesor.

Kompania NOA, është vendi i duhur ku eksperiencia dhe njohuritë ndahen mes punonjësve, ata gjejnë mbështetjen dhe kujdesin e duhur për t'u rritur profesionalisht.

Në fokus kryesor për kompaninë, përveç rekrutimit të më të mirëve, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë, politikat motivuese dhe vlerësuese për të krijuar marrëdhënie afatgjatë me stafin e saj. Në këtë kuadër vlen të përmenden promovimet e brendshme, përmirësimi i sistemit të bonuseve, kryesisht për forcën shitëse

duke ofruar një paketë mjaft tërheqëse dhe konkurruese në treg, ofrimin e kujdesit shëndetësor për punonjësit dhe sigurimin e jetës, shpërblimin për performancën në punë të punonjësve etj.

Departamenti i Burimeve Njerëzore ka patur një rol kyç në manaxhimin e gjithë këtij procesi, në përmbushjen e të cilit, ka kontribuar automatizimi i proceseve të burimeve njerëzore dhe rritja e cilësisë së mbështetjes së ofruar stafit, nëpërmjet një sistemi të automatizuar të Burimeve Njerëzore.

Ky sistem ka ardhur si një risi për kompaninë gjatë vitit 2014 i konceptuar për të përshpejtuar dhe standardizuar detyrat dhe procedurat administrative, si dhe për të krijuar të dhëna të sakta dhe lehtësisht të kërkueshme në momentet që lind nevoja, hartimin e analizave statistikore etj.

Kompania NOA Sh.a dëshiron gjithashtu, të jetë mbështetëse edhe në ndërtimin e të ardhmes e formimin e karrierës së studentëve. Një nga mënyrat që ajo përdor për të arritur këtë, është mundësimi i kryerjes së praktikave mësimore për studentët. Në këtë mënyrë atyre u ofrohet mundësia e konsolidimit të njohurive teorike, nëpërmjet përfshirjes në detyra konkrete, mbi bazën e një programi specifik trajnimi, sipas rastit.





1,717
orë trajnimi



Punonjës të rinj
1,488 orë



Punonjës të promovuar
229 orë

RRITJA E NIVELIT TË KUALIFIKIMIT DHE TRAJNIMI I STAFIT

Një vëmendje të veçantë Kompania NOA i kushton rritjes së nivelit të kualifikimit dhe trajnimit të stafit, duke ofruar mundësi trajnimi si për punonjësit e rinj, ashtu edhe për ata aktualë. Trajnimet kryesisht grupohen në 2 kategori, ato të brëndshme, kryesisht për stafin e ri dhe ato të jashtme, të organizuara kryesisht nga Kompani të jashtme trajnimi.

Departamenti i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me njësitë e tjera organizative të Kompanisë, organizon trajnimin e punonjësve të rinj, i konceptuar si një proces informues dhe orientues, teorikisht dhe praktikisht, me qëllim njohjen e filozofisë së Kompanisë dhe përshtatjen me vendin e punës. Rreth 87% e trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2014 i janë kushtuar punonjësve të rinj.

Viti 2014 ka shënuar rritje të numrit të trajnimeve të zhvilluara, duke mundësuar një pjesëmarrje më të gjerë të punonjësve të zyrave qendrore dhe degëve. Në kuadër të trajnimeve, vlen të përmendet organizimi i trajnimit profesional për forcën shitëse, gjatë muajve Prill dhe Dhjetor, trajnim i organizuar në bashkëpunim me “Genuine Effect” ku morën pjesë rreth 78 Këshilltarë Financiarë me eksperiencë, me tematikë: “Aftësitë dhe teknikat e shitjes” dhe “Shitjet Efektive”.

Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ishte rifreskimi i teknikave efektive të mbylljes së shitjeve, proceseve të shitjeve, rritja e kapaciteteve shitëse etj.



Gjithashtu, në bashkëpunim me kompaninë e trajnimit “WiFi Albania” dhe me mbështetjen e Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim, Kompania NOA Sh.a zhvilloi trajnimin 6 ditor me temë “Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Rritja Profesionale e Manaxherëve të Mesëm”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte identifikimi i nevojave për zhvillim nëpërmjet realizimit të takimeve individuale ndërmjet trajnerëve dhe menaxherëve të mesëm dhe të lartë; zhvillimi dhe rritja profesionale e menaxherëve të mesëm, bazuar në pikat kryesore si komunikimi, puna në grup, vendimmarrja, zgjidhja e problemeve, manaxhimi i performancës, strategjitë e motivimit etj.

Në muajin Dhjetor të gjithë manaxherët e mesëm, në përfundim të këtyre aktiviteteve arritën të adresojnë problematikat e hasura dhe erdhën me propozime konkrete, praktike dhe shumë të vlefshme në përmirësimin e manaxhimit të burimeve njerëzore për vitin 2015, të cilat u përkthyen në objektiva të Departamentit të Burimeve Njerëzore. Në mbështetje të objektivave strategjike të zhvillimit të biznesit, në fushën e burimeve njerëzore, Departamenti i Burimeve Njerëzore do të angazhohet në rritjen e avantazhit konkurrues të Kompanisë.

Ky është viti i dytë që NOA Sh.a kryen sondazhe mbi nivelin e kënaqësisë së stafit në punë, për të kuptuar nevojat e punonjësëve, si dhe për të gjetur mënyra për të përmirësuar kushtet dhe ambientin e punës.



RAPORTI AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

NOA

we finance



NOA

financojme...



financojme...

we finance



A

finance



NOA



financojme...

A

financojme...

NOA



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)22 74 524
+355(4)22 74 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.el

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
NOA Sh.a.

Tiranë, 17 Prill 2015

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të NOA Sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2014, pasqyrat e fitimi humbjeve dhe të ardhurave përmbledhëse të tjera, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinionimi

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014, rezultatit e saj financiar dhe rrjedhjen e parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Fatos Beqja

Director

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

NOA Sh.a.

Pasqyra e Vecante e Pozicionit Financiar

(Shumat ne mije Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	13	268,835	97,291
Hua institucioneve financiare	14	123,379	329,516
Hua dhe paradhenie klienteve	15	3,605,114	3,324,453
Investime ne letra me vlere	16	207,791	213,018
Aktive te qendrueshme te trupezuara	17	36,714	24,277
Aktive te qendrueshme te patrupezuara	18	15,402	34,152
Aktive te shtyra tatimore	19	10,321	9,419
Aktive te tjera	20	147,486	163,200
Totali i aktiveve		4,415,042	4,195,326
Detyrimet dhe kapitali aksioner			
Detyrimet			
Hua	21	3,466,373	3,217,471
Grante	22	9,546	14,949
Detyrime tatimore		-	4,166
Detyrime te tjera	23	99,941	86,962
		3,575,860	3,323,548
Kapitali aksionar			
Kapitali i paguar	24	731,839	731,839
Rezerve ligjore		6,201	1,757
Fitime te mbartura		101,142	138,182
		839,182	871,778
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		4,415,042	4,195,326

Pasqyra e vecante e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet e paraqitur nga faqja 5 deri ne faqen 42 dhe qe jane pjese perberese e pasqyrave te vecanta financiare.

NOA Sh.a.

Pasqyra e Vecante e Fitim Humbje dhe te Ardhurave Permbledhese te tjera

(Shumat ne mije Lek)

	Shënime	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor	
		2014	2013
Te ardhura nga interesat	6	942,780	854,210
Shpenzime per interesa	7	(355,400)	(373,210)
Te ardhura neto nga interesat		587,380	481,000
Te ardhura nga komisionet	8	119,432	129,874
Te ardhura te tjera	9	146,297	169,538
Te ardhura totale jo nga interesi		265,729	299,412
Shpenzime operative			
Shpenzime zhvleresimi	17	(15,479)	(16,928)
Shpenzime amortizimi	18	(19,619)	(21,288)
Shpenzime personeli	10	(283,336)	(272,906)
Humbje neto nga provizioni i huave dhe paradhenieve per klientet	15	(152,768)	(194,760)
Shpenzime te tjera	11	(210,006)	(176,829)
Fitimi neto nga kursi i kembimit		(1,249)	(1,157)
Totali i shpenzimeve operative		(682,457)	(683,868)
Humbje neto nga shitja e letrave me vlerë të investimit	16	(150,632)	-
Fitimi para tatimit		20,020	96,544
Tatimi mbi fitimin	12	(8,707)	(7,661)
Fitimi per vitin		11,313	88,883
Te ardhura te tjera permbledhese neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali i te ardhurave permbledhese per vitin qe i shperndahet aksionereve te Shoqerise		11,313	88,883

Pasqyra e vecante te ardhurave permbledhese duhet te lexohet sebashku me shenimet e paraqitur nga faqja 5 deri ne faqen 42 dhe qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

NOA Sh.a.

Pasqyra e Vecante e Flukseve te Parase

(Shumat ne mije Lek)

	2014	2013
Flukset e arkes nga aktivite operative:		
Fitimi per vitin	11,313	88,883
<i>Korrigjime per rakordimin e ndryshimeve te aktiveve neto ndaj mjeteve monetare neto nga aktivitetet operative:</i>		
Zhvleresimi	15,479	16,928
Amortizimi	19,618	21,288
Humbje nga shitja e investimeve	150,632	-
Nxjerrje nga perdorimi i aktiveve	43	67
Humbje neto nga provizioni	152,768	194,760
Amortizimi i granteve	(5,480)	(5,435)
Diferenca te kursit te kembimit nga rivleresimi i granteve	-	49
Te ardhura nga interest	(942,780)	(854,210)
Shpenzime per interesa	355,400	373,210
Shpenzime per tatim fitimin	9,082	7,661
Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet operative:		
Ndryshimi ne huate ndaj klienteve	(433,429)	(779,552)
Ndryshimi ne aktive te tjera	24,757	(20,967)
Ndryshimi ne detyrime te tjera	20,286	7,090
Mjete monetare neto te perdorura per aktivite operative	(622,311)	(950,228)
Interes i marre	941,641	860,234
Interes i paguar	(362,136)	(384,334)
Tatimi mbi fitimin i paguar	(22,147)	(7,159)
Flukse e arkes te perdorura ne aktivitetet operative	(64,953)	(481,487)
Flukset e arkes nga aktivite investuese:		
Blerje te aktiveve te qendrueshme te trupezuara	(27,957)	(3,832)
Blerje te aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	(1,270)	(2,560)
Rritja e depozitave me afat	206,137	(70,105)
Investimi ne letrave me vlerë Bono Thesari	(207,791)	-
Te ardhura nga shitja e investimit	62,386	-
Te ardhura nga huate e varura ne filiale	-	118,165
Flukse monetare nga aktivitetet investuese	31,505	41,668
Flukset e arkes nga aktivite financuese:		
Te ardhura nga rritja e borxheve	248,902	427,018
Zvogelimi i kapitalit	(43,910)	(119,001)
Flukset e arkes nga aktivitetet financuese	204,992	308,017
Ulje neto ne mjete monetare dhe ekuivalente me to	171,544	(131,802)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim te periudhes	97,291	229,093
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund te periudhes (shenimi 13)	268,835	97,291

Pasqyra e flukseve te parase duhet te lexohet sebashku me shenimet e paraqitur nga faqja 5 deri ne faqen 42 dhe qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

NOA Sh.a.

Pasqyra e Vecante e Ndryshimeve ne Kapital

(Shumat ne mije Lek)


	Kapitali aksionar	Rezerve ligjore	Fitime te mbartura	Totali
Gjendja me 1 Janar 2013	850,841	-	51,056	901,897
Fitimi neto i vitit	-	-	88,883	88,883
Totali i te ardhurave te tjera permbledhese	-	-	-	-
Totali i te ardhurave permbledhese per periudhen	-	-	88,883	88,883
Transaksione me pronaret e Shoqerise, te njohura direkt ne kapital				
Rezervaligjore	-	1,757	(1,757)	-
Rritja e kapitalit aksionar	(119,002)	-	-	(119,002)
Kontributi total nga dhe shperndarja per pronaret	(119,002)	1,757	(1,757)	(119,002)
Gjendja me 31 dhjetor 2013	731,839	1,757	138,182	871,778
Fitimi neto i vitit	-	-	11,313	11,313
Rezervaligjore	-	-	-	-
Totali i te ardhurave te tjera permbledhese	-	-	11,313	11,313
Totali i te ardhurave permbledhese per periudhen				
Transaksione me pronaret e Shoqerise, te njohura direkt ne kapital	-	4,444	(4,444)	-
Rritja e kapitalit aksionar			(43,909)	(43,909)
Kontributi total nga dhe shperndarja per pronaret	-	4,444	(48,353)	(43,909)
Gjendja me 31 dhjetor 2014	731,839	6,201	101,142	839,182

Pasqyra e vecante e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet e paraqitur nga faqja 5 deri ne faqen 42 dhe qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Drejtimi i Shoqërisë ka autorizuar këto pasqyrave financiare më 16 Prill 2015 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


Herjola Spahiu
Drejtor Ekzekutiv




Perlat Sulaj
Drejtor i Finances

NOA Dega Tiranë

Rruga Ferit Xhajko nr 128
Tiranë
Cel: +355 68 40 01 318

NOA Agjensia Tirana 1

Adresa: Rr. e Durrësit,
Përballë rrugës së ambasadave,
Tiranë
Cel: +355 69 400 13 79

NOA Agjensia Tirana 3

Adresa: Unaza e Re, Rr. Teodor Keko,
Përballë karburant "IT Oil", Tiranë
Cel: +355 68 90 31 041

NOA Agjensia Komuna e Parisit

Adresa: Rruga "Dervish Bej Mitrovica"
Komuna e Parisit, Tiranë
Cel: +355 68 40 29 667

NOA Dega Sauk

Adresa: Rr. e Elbasanit,
Pranë Akademisë së Policisë
Sauk, Tiranë
Cel: +355 68 40 01 395

NOA Dega Kombinat

Adresa: Rr. "Llazi Miho"
Kombinat, Tiranë
Cel: +355 68 40 29 578

NOA Dega Kamëz

Adresa: Bulevardi Blu,
Pranë shkollës "Ibrahim Rugova"
Kamëz
Cel: +355 68 40 29 569

NOA Dega Durrës

Adresa: Rr. Aleksandër Goga, L. nr. 6,
Pranë shkollës "Nënë Tereza", Durrës
Cel: +355 68 40 29 819

NOA Dega Lezhë

Adresa: L. Besëlidhja, Rr. Luigj Gurakuqi
Pll. Jeshil, Kati II, Lezhë
Cel: +355 69 60 84 082

NOA Dega Shkodër

Adresa: Rr. Daut Boriçi
Sheshi "Perash", Shkodër
Cel: +355 68 90 31 065

NOA Dega Elbasan

Adresa: L. Kala,
Rr. "Bedri Xhomo"
Elbasan
Cel: +355 68 40 29 699

NOA Dega Pogradec

Adresa: L. nr. 5, Rr. Unaza,
Përballë rrugës "Rinia"
Pogradec
Cel: +355 68 40 29 853

NOA Dega Korçë

Adresa: Rr. "Konferenca e Pezës"
Pranë parkut "Vangjush Mio"
Korçë
Cel: +355 68 40 29 696

NOA Agjensia Bilisht

Adresa: Shëtitorja "Fuat Babani"
Bilisht
Cel: +355 68 40 29 696

NOA Dega Lushnje

Adresa: L. Xhevdet Nepravishta,
Rr. Marin Barleti, pranë shëtitores
"Kongresi i Lushnjes", Lushnje
Cel: +355 68 40 29 806

NOA Dega Berat

Adresa: Bulevardi "Republika"
